

UDHËZIM
Nr. 32, datë 5.10.2018

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 18, DATË 21.5.2018, “PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË VITIN AKADEMIK 2018–2019”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 18, datë 21.5.2018, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ndryshuar, pas pikës 1, të kreut IV, “Raundi i tretë”, të shtohet pika 1/1, me përmbajtjen si më poshtë:

“1.1 Për maturantët që nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë dhe në raundin e dytë, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe respektojnë kriterin e notës mesatare, sipas vendimit nr. 216, datë 20.4.2018, të Këshillit të Ministrave, mund të bëhen pjesë e raundit të tretë, pasi të kenë aplikuar në portalin *U-Albania*, duke ndjekur procedurën e parashikuar në pikën 5, germa A, kreu III, të këtij udhëzimi. Kjo procedurë të kryhet brenda datës 18 tetor 2018, pasi të jetë kryer më parë konfirmimi në portalin *U-Albania* nga institucionet e arsimit të lartë, ku këta maturantë janë të interesuar të studiojnë.”

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, njësitë arsimore vendore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla